



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEBVE MBËSHTETËSE

Nr. 3496/ prot.
15

Tiranë, më 09.07.2025

Lënda: Njoftim.

ZNJ. ADELINA BISTRI

Në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VII, neni 162, pas shkresës Nr. 3496/3, datë 18.6.2025 "*Njoftim*", të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dërguar znj. Adelina Bistri, në adresën e deklaruar më herët prej saj në dosjen personale (rruga "Myslym Shyri", pallati 1/3, apartamenti 7/a, Tiranë), në kushtet kur nga shërbimi postar rezulton se njoftimi është kthyer mbrapsht me shënimin "*ka ndryshuar adresë*", pas njoftimit elektronik në adresën adelinabistri@yahoo.com, të njoftimit të sipërcituar, më datë 25.6.2025, si dhe pas shkresës përcjellëse për rikthim në punë Nr. 3496/4, datë 4.7.2025, dërguar në adresën e konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (rruga "Myslym Shyri", ndërtesa 62, hyrja 8, apartamenti 28), e cila gjithashtu u kthye mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin "*ka ndryshuar adresë*", Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vendosi njoftimin publik të znj. Bistri, si më poshtë vijon:

Në mbështetje të nenit 66/1, të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 "*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil*", të ministrit të Shtetit për Inovacionin e Administratës Shtetërore, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 44, datë 24.1.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe shkresës Nr. 3496/3 datë 18.6.2025 "*Njoftim*" dhe shkresës Nr. 3496/4, datë 4.7.2025, të Komisionit të Posaçëm në MBZHR, ju bëjmë me dije se Komisioni pasi shqyrtoi kriteret e përgjithshme e specifike të pozicionit të punës përpara lirimit tuaj, si specialiste në Sektorin e Produkteve Ujore, me kategori page III-b, si dhe pozicioneve aktuale të lira në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, konkludoi se pozicioni i punës ku ju plotësoni kriteret e përgjithshme e specifike është:

Specialist në Sektorin e Produkteve dhe Nënprodukteve me Origjinë Shtazore, në Drejtorinë e Politikave të Sigurisë Ushqimore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kategoria IV-1.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në zbatim të kreut IV, të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, *“Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”*, vendosi t’ju njoftojë përmes *“shpalljes publike”*, për pozicionin e ofruar, si rezultat i zbatimit të vendimit të formës së prerë dhe për pranimin apo refuzimin e së cilit duhet të njoftohet nga gjyqfituesi, Komisioni i Posaçëm në MBZHR, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, pjesa VII, neni 162, pika 3, bëjmë me dije se ky njoftim, përveçse në këndin e njoftimit në ambientet e Njesisë Bashkiake nr. 7, ku znj. Bistri rezultoi e regjistruar, gjendet edhe në këndin e njoftimit në MBZHR, në faqen zyrtare elektronike *“bujqesia.gov.al”*, si dhe në faqen elektronike të Njesisë Bashkiake nr. 7, *tirana.al/njesia-administrative/njesia-nr. 7*.

Njoftimi shpallet sot më datë 9.7.2025 dhe hiqet më datë 19.7.2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dritan Palnikaj

